

### KORI I VAJZAVE

#### KORI I VAJZAVE TË LICEUT ARTISTIK "JORDAN MISJA" NË BERLIN

Falë mbështetjes së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kori i Vajzave të Liceut Artistik "Jordan Misja" ka marrë pjesë dhe ka performuar në "Takimin Ndërkombëtar të Koreve" në Berlin mes datave 15-19 Gusht, 2019 - një aktivitet i organizuar nga Shoqata e Koreve të Berlinit në Gjermani.

Ky bashkëpunim është i dyti që nga 2017-ta dhe tregon më së miri cilësinë e lartë të interpretimit të Korit të Vajzave të Tiranës duke performuar këngët korale shqiptare për publikun gjerman si dhe duke pasuruar repertorin koral me zhvillimet aktuale të koreve në Evropë.

### ÇMIM I PARË NË TEKNOLOGJI

#### APLIKACIONI "GJEJZÂ", ÇMIM TË PARË NË "SILICON VALLEY"

Grupi D3c0ders i 3 gjimnazisteve shqiptare (Dea, Arla dhe Jonada) kanë nderuar Shqipërinë duke fituar kupën e vendit të parë në garën ndërkombëtare të teknologjisë "Technovation Challenge" në "Silicon Valley", SHBA.

Me aplikacionin e tyre "GjejZâ" ato konkurruan duke prekur një temë shumë të ndjeshme siç është dhuna ndaj grave dhe vajzave.

### PORTALI "MËSUES PËR SHQIPËRINË"

#### VIJON TESTIMI I INFORMATIZUAR PRANË QSHA

Procesi i testimit të informatizuar vijon pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), i cili konsiston në fazën e dytë që duhet ndjekur për t'u punësuar nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë".

Deri sot, kanë zhvilluar testimin mbi 3,600 kandidatë dhe procesi i testeve do të vazhdojë deri më datë 22 Gusht duke u organizuar sipas profileve të ndryshme të punësimit.

Nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë" pritet që gjatë vitit të ardhshëm shkollor të punësohen rreth 1,300 - 1,400 mësues, teksa portali siguron që pjesë e sistemit të jenë më të mirët në bazë meritokracie dhe garanton transparencë, efikasitet dhe cilësi të dhënash.

### KUNE, LEZHË

#### AKSION VULLNETAR PËR PASTRIMIN E PLAZHIT TË KUNES

Në kuadër të sistemit të patronazhimit të zonave turistike në Qarkun e Lezhës, Ministria Besa Shahini së bashku me një grup të rinjsh vullnetarë kanë zhvilluar një tjetër aksion pastrimi në plazhin e Kunes.

Në thelb të këtyre aksioneve vullnetare qëndron sensibilizimi që duhet të ketë çdo individ dhe çdo institucion i përfshirë për të treguar përgjegjshmëri dhe menaxhim